



Projekti "Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale"

PAKETA INFORMUESE
MBI PËRGJEGJËSITË E PUSHTETIT VENDOR DHE TË
DREJTAT E PUBLIKUT PËR TRANSPARENCËN DHE
PJESËMARRJE NË VENDIMMARRJE



Lenda:

Paketa informuese mbi përgjegjësitë e Pushtetit Vendor dhe të drejtat e publikut për transparencën dhe pjesëmarrje në vendimmarrje	4
Hyrje.....	4
1. Baza ligjore.....	4
2. Baza ligjore mbi detyrimet e NJQV për aspekte të veçanta të mjedisit.....	5
3. Konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.....	7
4. Pjesëmarrja e KEL në ushtrimin e detyrimeve ligjore në vendimmarrje në qeverisjen lokale, të Bashkisë Lezhë.....	8
5. Programi i transparencës së Bashkisë së Lezhës.....	10
6. Staf i përgjegjës për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të BL.....	10
7. ANEKSE.....	11

Shkurtesa

AdZM	Administrata e Zonave të Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AKB DL	Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Dega Lezhë
BL	Bashkia Lezhë
BE	Bashkimi Evropian
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
DT	Drejtoria e Turizmit Bashkia Lezhë
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike Bashkia Lezhë
DBUAP	Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve Bashkia Lezhë
EC	Drejtoria e Emergjencat Civile Bashkia Lezhë
INCA	Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, Shqipëri
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IVMT	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
KEL	Klubi Ekologjik Lezhë

KKSH	Kryqi i Kuq Shqiptar
KM	Këshilli i Ministrave
KMC	Komisioni i Mbrojtjes Civile
KUZ	Kanalizimet e Ujërave të Zeza
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MEKVT	Rrjeti "Mbrojmë Ekosistemin Kune Vain Tale" .
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
Nj.A	Njësia Administrative
Nj.V.K.SH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PMZM	Plani i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PVM	Plani i Veprimit në Mjedis
QL	Qarku Lezhë
RRF	Reduktimi i Riskut të Fatkeqësive
SA	Strategjia e Advokimit
Sh.a.UKZ	Shoqëria Anonime, Ujësjetes Kanalizime Lezhë
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

Paketa informuese mbi përgjegjësitë e Pushtetit Vendor dhe të drejtat e publikut për transparencën dhe pjesëmarrje në vendimmarrje

Hyrje

Transparenca dhe pjesëmarrje në vendimmarrje është një parim bazë i rëndësishme për një vetëqeverisje vendore të mirë dhe demokratike. Transparenca është publikimi i informacionit mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, (organet dhe administrata e bashkisë), menaxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofron bashkia, pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë ku përfshihen dhe OJF-të, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë. Transparenca është e lidhur ngushtë me llogaridhënien dhe bazë e rëndësishme për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje .

1. Baza ligjore

Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve dhe të gjithë grupeve të shoqërisë, akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre.

Bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, njesitë e vetëqeverisjes vendore, Bashkitë, “.....janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes”, (neni 16), ku specifikohet (pika 2 e ketij neni) se “ Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në këtë kuader qëndron dhe mundësia dhe hapësira e bashkëpunimit të OSHC dhe Bashkisë.

Po ashtu, OSHC mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Keshillit Bashkiak, pasi ato janë të hapura për publikun (Neni 17 , pika 1). OSHC kanë një spekter të gjërë çeshtjesh në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ku mund të mbeshtesin bashkëpunimin dhe aksionin ne realizimin e objektivave të saj, pasi bazuar në këtë ligj,

bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për (neni 23, ne vijim të lidhuar direkt me mjedisin):

- Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

OSHC, kanë hapësira të medha ligjore bashkëpunimi me NjVV pasi ato janë përgjegjëse direkt në mbrojtjen e mjedisit për kryerjen e funksioneve (neni 26):

- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
- Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

2. Baza ligjore mbi detyrimet e NJQV për aspekte të veçanta të mjedisit

Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" me amendimet përkatëse, ka si qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin" e ndryshuar; Në këtë Ligj specifikohet se Kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës (Neni 22).

Mbrojtja e natyrës dhe parimet e përgjithshme, garantohen edhe nëpërmjet ligjit të ciperçituar (në nenin 5) në të cilin është përcaktuar se "ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike" është një prej elementeve të mjedisit.

Ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës në Republikën e Shqipërisë, nga të cilat mund të përmendim:

Ligji "Për mbrojtjen e Biodiversitetit" i ndryshuar, synon të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik, të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve, të sigurojë ngritjen e

rjetit për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë. Po ashtu ky ligj synon të përcaktojë masa për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm ruajtjeje habitatet natyrore dhe llojet e faunës së egër të Shqipërisë dhe me interes për Komunitetin Europian, të sigurojë që masat e ndërmarra, në zbatim të këtij ligji, të marrin në konsideratë kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonale.

Ligj nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privatë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre.

Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" ka për qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritimit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për këtë qëllim. Në këtë Ligj, përcaktohen në mënyrë specifike (neni 9) se si **pjesëmarrja e publikut** në përgatitjen e planeve të cilësisë së ajrit dhe planeve të veprimit afatshkurtër.

Ligji nr.9774, datë 12.7.2007. për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Ne zbatim të këtij Ligji është dhe Vendim nr. 587 datë 07.07. 2010 për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.

Po ashtu, strukturat e Njësive të Qeverisjes Vendore (bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”) zbatojnë të gjitha kriteret ligjore në fuqi dhe masat e mbrojtjes nga zhurmat, duke aplikuar dhënien e lejeve për lokalet e ndryshme sipas këtij përcaktimi:

- Për ambientet e hapura për ditën e premtë dhe të shtunë orari i lejimit të aktivitetit do jetë nga ora 19.00 deri në orën 24.00, ndërsa për ditët e tjera të javës orari i lejimit të aktivitetit do të jetë nga ora 19.00 deri në orën 23.00 konform normave të lejuara të zhurmës..
- Për ambientet e mbyllura, aktiviteti do lejohet pa kufizime orari, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës....

Ligji nr. 111/2012, datë15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar, ka si qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare,të

ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;

Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ka si qëllim:

a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;

b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;

Ligji nr.10440 datë 7.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" me ndryshimet përkatëse, specifikon dhe përcakton kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis të projekteve të propozuara, private apo publike cilët janë, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces, mënyrën e miratimit të lejes mjedisore; Në këtë ligj specifikohet përfshirja në procesin e VNM e Njesise se Qeverisjes Vendore, Publikut dhe OJF, (Neni 14), informimi i publikut gjate procesit te VNM-se (Neni 16), dhe seanca degjimore (Neni 17) ".....njësia e qeverisjes vendore bën njoftimin drejtuar publikut dhe OJF-ve të interesuara për të marrë pjesë në takim".

Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi;

Ky ligj është përafëruar plotësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 "Mbi mbetjet", Në këtë ligj specifikohet se "Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin;

3. Konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykates për çeshtjet e mjedisit

Një ndër rrugët e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mjedisit është pjesëmarrja e Shqipërisë në konventat mjedisore.

Konventa “per te drejten e Publikut per informacion, pjesmarrje ne vendim marrje dhe te drejten per t’ju drejtuar gjykates, per çeshtje qe lidhen me mjedisin (Aarhus). 25 Qershor 1998 Danimarkë

Ligji 8672 date 26.10.2000 “Per ratifikimin e “Konventes së Aarhusit për të drejten e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykates për çeshtjet e mjedisit”.

VKM nr. 994, 2.07.2008 “Per terheqjen e mendimit te publikut be vendimmarrje për mjedisin” synon pjesmarrje e publikut në hartimin e politikave, të strategjive rajonale e kombëtare, të përgjithëshme e sektoriale, dhe të planeve të veprimit në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve, që përmirson përmabjtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre.

Në ushtrimin e përgjegjesive ligjore për të drejtat e publikut për transparencën dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, NJQV hartojnë dhe publikojnë programin e trasnparencës.

Nëpërmjet Programit të transparencës, bashkia vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato. Programi model është hartuar në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të kushtetutës, ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe të ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”.

4. Pjesmarrja e KEL në ushtrimin e detyrimeve ligjore në vendimmarrje ne qeverisjen lokale, të Bashkisë Lezhë.

KEL prej vitesj është antare e Keshiilit të Basenit Ujor të Lumit Drin, si përfaqesuese e vetme e shoerisë civile, dhe ngritur me forcë, kompetence ligjore e teknike mjaft problematika mjedisore që bien në kundërshtim të hapur me parimet e zhvillit të qëndrueshëm. Rasti me tipik është ai i miratimit të HEC-ve, në basenin e këtij lumi.

KEL është antar i Komitetit të Menaxhimit të zonave të mbrojtura të Lezhës dhe ka ngritur të gjitha çeshtjet që diskutohen në rrjetin “Mbrojmë Ekosistemin Kune Vain Tale”.

Gazeta “Kurora e gjelbert”, si organ i KEL, produkt i mendimit shkencor intelektual e mjedisor të një spektri të gjerë personalitetesh të njohura brenda e jashtë vendit, ka pasqyruar, informuar, lobuar e kritikuar me forcë mjaft aspekte të fushës mjedisore, ku komplementohen parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ka përcaktuar e hartuar plane veprimi, e ka ndermarrë aksione konkrete për zgjidhjen e tyre.

KEL në bashkëpunim me stafin e BL, është në proces hartimi të guides për këtë Bashki, ku sintetizohen në mënyrë konçize, mendimet shkencore të të gjitha fushave për këtë “pasaportë” që e identifikon BL. E gjithë veprimtarinë për hartimin e guides është mbështetur në hartimin e një marrëveshje të detajuar e specifike për detyrimet e paleve. KEL po bashkëpunon gjithashtu për këtë qëllim me stafin akademik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe me instituti shkencore relevante.

Me 15 mar 2016 kel ka formalizuar e miratuar **marrëveshjen afatgjatë të bashkëpunimit në bashkinë e Lezhës me qëllim ndertimin e lidhjes së qëndrueshme në realizim të projekteve mjedisore, shkëmbim të përvojës e ekspertizës, përvojës dhe resurseve të përbashkëta.**

Me anë të kësaj marrëveshje është dakordësuar mbështetja e projekte reciproke në **drejtim të nxitjes së përfshirjes së komunitetit për zgjidhjen dhe përmirsimin e situatave problematike mjedisore, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta, dhe do të realizojnë projekte nga fusha e kësaj marrëveshje.**

Sipas kësaj marrëveshje, palët do të ndërmarrë projekte strategjike apo veprimtari advokative në nivel vëndor, për të mundësuar krijimin e një mjedisi që nxit demokraci vendore më të mirë për një zhvillim të qëndrueshëm miqësor me mjedisin. Në vzbatisim të kësaj marrëveshje është kriju dhe një komiteti i përbashkët prej 5 antaresh.

KEL ka krijuar një eksperiencë të gjatë në drejtim të rritjes së autoritetit të saj si përfaqësuese e shoqërisë civile në vendimarrje gjatë hartimit të një serë dokumentesh me karakter studimor, monitorues e me rëndësi strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të BE, dhe në veçanti mbrojtjen e ekosistemit Kune Vain Tale e konkretisht:

Studimi e botimi i broshures “Menaxhimi i qëndrueshëm i Ekosistemit Kune Vain Tale”, i përgatitur nga në kuadrin e zbatimit të projektit “Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune - Vain - Tale” mbështetur nga INCA, 2021.

Hartimi dhe botimi i broshures “Ndikimet e lumit Drin në ekosistemet e Kune Vain Tale”, në kuadrin e zbatimit të projektit “Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të ekosistemit të rezervatit natyror Kune - Vain - Tale” mbështetur nga INCA, 2020.

Po ashtu KEL ka kryer shërbimin e ekspertizës : “Raport mbi rishikimin e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur KVT”, 2019, i cili skanon në mënyrë të detajuar të gjithë përmbajtjen e planit, zërat e zbatuar nga ky plan, problematikat në implementimin e tij, konsultat me aktorët relevant, argumenton nevojat e rishikimit të plotë të këtij plani e i adreson këto çështje tek institucionet përgjegjëse.

Te gjithë aktivitetin që lidhet me ndikimet e pjesëmarrjen e KEL në vendimarrje dhe si lider i rrjetit MEKVT e ka pasyruar në faet e saj të FaceBook-ut. (<https://www.facebook.com/qendraekerkimit.mjedisore>).

5. Programi i transparencës së Bashkisë së Lezhës¹

Programi i transparencës së bashkisë Lezhë është i përberë nga kapituj e konkretisht:

- Hyrje, (kap 1) në të cilën paraqitet baza ligjore ku mbeshtetet ky program, qëllimi, çfarë synohet të arrihet, përmbajtja, si bëhet publikimi i dokumentave etj
- Parime të përgjithshme (kap. 2). Në këtë kapitull evidentohen parimet bazë të përcaktuara për të drejtën e informimit në Kushtetutë, si dhe shtjellime specifike që lidhen me zbatimin korrekt të ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Lezhë dhe përkatësisht: Ligji nr. 8652, datë. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar me ligj nr.30/2015 dhe Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Informacioni që bëhet publik pa kërkesë (kap 3), ku paraqiten kategoritë e informacionit që Bashkia Lezhë vendos në dispozicion të publikut në në faqen e saj të internetit / dhe në mjediset e institucionit

Është e rëndësishme të theksohet se në këtë program evidentohet se Bashkia Lezhë, “krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë”;

- Programi i transparencës (kap 4), pasqyron programin e plotë të transparencës si dhe regjistrat e kërkesë/ankesave.
- Publikimi (kap. 5) si dhe Monitorimi (kap.6) pasqyrohet se çfarë publikohet dhe si, dhe si zbatohet ligji për të drejtën e informimit etj.

6. Staf i përgjegjës për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të BL.

Koordinatorë për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për BL, është:

Xhulia LEKAJ

Email: xhulia.lekaj@bashkialezhe.gov.al

Orari i punës së kordinatorës:

Hënë-Enjte: 08:00-16:30

E Premte: 08:00-14:00

¹ <https://lezha.gov.al/programi-i-transparences/>

Adresat elektronike për dërgimin e kërkesave për informim dhe ankesave për mos dhënie informacioni:
info@lezha.gov.al; xhulia.lekaj@bashkialezhe.gov.al

7. ANEKSE

Aspekte të programit të transparencës së BL që lidhen më shumë me çeshtjet mjedisore

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

Fusha 2 - Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
3.	Plani Strategjik i Zhvillimit të bashkisë. Përmban: 1. Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite 2. Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësi 3. Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse 4. Burimet e financimit	Neni 32 të ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)	10 ditë nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë

Fusha 3- Për kërkesat për informim

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat) Përshihni bërjen publike të: 1. Emrit mbiemrit të Koordinatorit 2. Adresës postare/elektronike të tij 3. Orarit të punës 4. Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit 5. Adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim	Neni 7/ç i ligjit nr. 119/2014 dhe neni 15/3 i ligjit nr. 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)	M menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

2.	Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës. Përfshin bërjen publike të: 1. Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion 2. Adresës postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim 3. Modelit standard të një kërkesë për informim 4. Afateve të marrjes së përgjigjes 5. Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni 6. Adresës postare/elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni	Neni 7 dhe 11/4 ligjit nr. 119/2014 dhe neni 64/j i ligjit nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
3.	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Përfshin bërjen publike të: 1. Të gjitha kërkesave për informim 2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim 3. Përditësimi i regjistrit	Neni 7/i i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
4.	Informacion i dhënë më parë	Neni 9 i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)	Menjëherë	Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
5.	Trajtimi i kërkesave për informacion Përfshin bërjen publike të: 1. Procedurës së regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2. Afateve të trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë 3. Mënyrave të dhënies së informacionit	Neni 11, 12 dhe 14 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)		Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit

6.	Kufizimi i së drejtës së informimit Përfshin bërjen publike të: 1. Rasteve të kufizimit të së drejtës për informim;	Neni 17 i ligjit Nr. 119/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresa e vendeve)		Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
7.	Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka) Përfshin bërjen publike të: 1. Tarifave 2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës 3. Subjekteve që përfitojnë informacionin falas	Neni 13/1 i ligjit Nr. 119/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresa e vendeve)	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për të drejtën e informimit
8.	Informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh. Përfshin bërjen publike të: 1. Gjithë informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim	Neni 7/k i ligjit nr. 119/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresa e vendeve)	Menjëherë	Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron bashkia						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin

1.	<p>Shërbimet Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike 2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale 3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese 4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit 5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit 6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor 7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike 8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara..... Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit ✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet ✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës ✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor 	Neni 32-33 i ligjit nr. 139/2015	<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktruara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
2.	<p>Shërbimet administrative Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike 		<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktruara</p>	Menjherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

	<p>2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale</p> <p>3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese</p> <p>4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit</p> <p>5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike natyrës dhe biodiversitetit</p> <p>6) Shërbimet administrative në fushën e zhvillimit ekonomik vendor</p> <p>7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike</p> <p>Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkruar mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit - Adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sporteve që ofrojnë shërbime administrative - Procedurat që duhen ndjekur për të përfutur shërbime administrative - Oraret e punës së strukturave/njësive/sporteve që ofrojnë shërbime administrative - Tarifat për shërbimet administrative - Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës - Subjektet që përjashtohen nga tarifat 		<p>për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)</p>			
3	<p>Kontratat publike. Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objektivit të kontratës publike - Numrit të referencës së procedurës/ kontratës - Llojit të procedurës - Termave dhe kushteve të kontratës - Kohëzgjatjes së kontratës - Vlerës së kontratës - Dhënave të autoritetit kontraktor - Dhënave të kontraktorit/nënkontraktorit 	<p>Neni 7/ i ligjit Nr. 119/2014 si dhe neni 25 dhe 71 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)</p>	<p>Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

1.	<ul style="list-style-type: none"> - Treguesve për matjen e përbushjes së kontratës - Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës - Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim - Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës 					
4	<p>E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet</p> <p>Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet 2. Adresës postare/clektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve 		<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të drejtën e informimit</p>
Fusha 5 - Legjislativi dhe aktet e brendshme rregullatore						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin

1.	Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të: 1. Emër mbiemër të koordinatorit 2. Adresën postare/elektronike të tij 3. Orarin e punës	Neni 16/2 ligjit Nr. 139/2015 dhe neni 10 ligji Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë pas miratimit të urdhrimit të caktimit të Koordinatorit	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
2.	Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje. Përfshin bërjen publike të: 1. Akteve që do të konsultohen 2. Mënyrat e konsultimit 3. Afatet 4. Strukturat përgjegjëse	Neni 6/b i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
3.	Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun. Përfshin bërjen publike të: Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim	Neni 18/2 i ligjit 139/2015 dhe neni 6 ligji 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak
					Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

4.	Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përfshin bërjen publike të: 1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik	Neni 18/1 ligjit Nr. 139/2015 Neni 5/ç dhe 13/3 e ligji Nr. 68/2017 Neni 1/1 dhe 4/c e ligjit 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
5.	Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje Përfshin bërjen publike të: 1. Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij. 2. Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë 3. Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; 4. Adresën e kontaktit të koordinators për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin; 5. Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij	Neni 11, neni 13 dhe neni 14 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
6.	Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve. Përfshin bërjen publike të:	Neni 15 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

	<ol style="list-style-type: none"> Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve 		b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)			Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
7.	<p>Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i bashkisë, Kryetari i bashkisë); Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën 	Neni 21 i ligjit Nr. 146/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
8.	<p>Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes Numrin e takimeve publike të organizuara 	Neni 20/1 i ligjit Nr. 146/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
9.	<p>Iniciativa qytetare. Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare 	Neni 20/1 Ligji Nr. 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

			link)			
	<p>2. Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare</p> <p>3. Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare.</p> <p>4. Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare</p>		b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)			Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
Fusha 7 - Informacion tjetër						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<p>Bashkia në proceset e integritimit evropian. Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE.</p>	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	Koordinatori për të drejtën e informimit
2.	<p>Bashkia dhe shoqëria civile. Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit</p> <p>2. Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit</p> <p>3. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme</p> <p>4. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile</p>	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	Koordinatori për të drejtën e informimit

3.	Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës. Përfshin bërjen publike të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT 2. Sisteme/metodologji matje të PT 	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	Këshilli Bashkiak Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
4.	Strukturat komunitare Përfshin bërjen publike të:	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- 	Brenda 10 ditëve nga data	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për të drejtën e informimit
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat 2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet 3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare 4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare 		menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	e miratimit të tyre		